



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:260687

Datë: 10.04.2020

Numri i dokumentit: 00904496

A.nr.1010/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Rexhep Gashi dhe me zyrtaren ligjore Asliha Fejzullahu, si procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditësit NH “R.T.” me seli në H. të E., kundër të paditurës Komuna e H. të E., duke vendosur sipas padisë për anulimin e aktit administrativ të paditurës 08-nr.4092-2017 i datës 08.06.2017, jashtë seancës, me datë 10.04.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit NH “R.T.” me seli në H. të E.
- II. **ANULOHET** akti administrativ 08-nr.4092-2017 i datës 08.06.2017i Komunës së H. të E.- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me aktin administrativ kontestues 08-nr.4092-2017 i datës 08.06.2017të titulluar si përgjigje në ankesë e paditura Komuna e Hanit të Elezit-Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka refuzuar si të ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e lëshuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e Komunës të Hanit të Elezit 08-nr.2653/93-2017 të datës 23.05.2017, me të cilin paditësi ishte ngarkuar me pagesën e taksës vjetore, për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit për vitin 2017, në shumë prej 200.00€.

Paditësi përmes të autorizuarit av.Sabri Kryeziu, me padinë e paraqitur në gjykatë, me datë 15.06.2017, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Komuna e Hanit të Elezit, siç kuptohet nga padia për shkak se nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore dhe nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike dhe se akti përfundimtar i të paditurës është nxjerr në kundërshtim me ligjin, me të cilin ka kërkuar aprovimin e padisë si të bazuar, anulimin e akteve administrative të paditurës me nr.08-nr.2653/93-2017 i datës 23.05.2017 dhe nr.08-nr.4092-2017 i datës 08.06.2017, si dhe paditësi të lirohet nga pagesa e ngarkesës në shumë prej 200.00€.

Tutje paditësi në padi ka theksuar se aktvendimin e shkallës së parë të paditurës e ka goditur për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, duke u thirr në bazën ligjore se është në tërësi i kundërligjshëm e posaçërisht baza juridike nga neni 58 par.1 pika d) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale fare nuk ka të bëjë me autorizime ligjore që bazohet aktvendimi, ashtu siç nuk ka të bëjë fare me bazën

juridike nga neni 24 i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Ka shtuar se e paditura duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit nga ana e Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Ngarkesat Vjetore të ushtrimit të veprimtarisë afariste, e ka refuzuar ankesën e paditësit me aktin 08-nr.4092-2017 të datës 08.06.2017, duke mos dhënë asnjë arsyetim të përcaktuar me nenin 85 dhe 86 të LPA-së, për ti arsyetuar pretendimet në ankesë, por akti përfundimtar i të paditurës është pa arsyetim, pa të dhëna të qarta, është kontradiktor dhe rrjedhimisht është i barasvlershëm me mungesën e arsytimit.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi të datës 21.10.2019 ka deklaruar se e konteston padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si jo përmbajtësore dhe të pa bazuar në fakte dhe argumente. Ka theksuar se me Ligjin për Financat dhe Pushtetin Lokal të Republikës së Kosovës nr.03/L-049, dispozitat e nenit 10 paragrafi 10.2, komuna mund të përcaktoj taksa vjetore përmes rregullores nga Kuvendi i Komunës, si organ vendimmarrës për ushtrim të veprimtarisë dhe me këtë rast komunat çdo vit miratojnë rregullore për taksa dhe tarifa administrative për subjektet afariste dhe taksa të tjera të ndryshme sipas dispozitave ligjore. Në padi paditësi ka elaboruar Ligjin për Tregti të Brendshme nr.04/L-005, neni 38.3 lejet e punës, por kjo nuk është e njëjtë me taksën e ushtrimit të veprimtarisë. Leja e punës lëshohet nga ana e organit kompetent komunal sipas nenit 38.3, leja e punës është e përhershme sipas nenit 38.4. Andaj e paditura i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar, dhe që të obligohet paditësit në pagesën e shpenzimeve të procedurës gjyqësore.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 35 i Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), me të cilin përcaktohet se *“nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigje”* dhe ka gjetur se në këtë konflikt administrativ plotësohet kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa mbajtjen e seancës për shqyrtimin verbal dhe vlerësimin e fakteve.

Nga shkresat e lëndës, del se paditura me shkresën-përgjigjen në ankesë 08.-nr.4092-2017 të datës 08.06.2017 e ka njoftuar paditësin për refuzimin e ankesës dhe mbetjen në fuqi të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e Komunës së Hanit të Elezit 08-nr.2653/93-2017 të datës 23.05.2017, me të cilin vendim paditësi ishte ngarkuar me pagesën e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit, për vitin 2017 në shumë prej 200.00€.

Nga vendimi i kontestuar gjykatës i rezultojë se ai përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljen thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Administrative nr.02/L-28 i cili ka qenë në fuqi deri me 21 qershor 2017, kur ka hyrë në fuqi Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të dispozitave të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 paragrafi 2 të këtij ligji si ligj i aplikueshëm në kohën kur është nxjerr vendimi kontestues është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e kontestuar, duhet patjetër të përmbajë, përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilën bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Neni 85 i ligjit të njëjtë parasheh se përveç rasteve kur ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë vendim në lidhje me kërkesat për rishqyrtim apo ankimet, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimi duhet të formulohet qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të rastit (neni 86 paragrafi 1 i të njëjtit ligj). Arsyetimi me të

dhëna të pa qarta, kontradiktore ose të pasakta, është i barasvlershëm me mungesën e arsytimit sipas nenit 86.3 të këtij ligji.

Gjykata konstaton se në rastin konkret shkresa e të paditurës e titulluar përgjigje në ankesë e datës 08.06.2017, nuk ka formën dhe përmbajtjen e aktivitetit administrativ të përcaktuar me ligj, prandaj është akt administrativ absolutisht i pa vlefshëm dhe kjo është përcaktuar edhe në nenin 92, pika c, të Ligjit nr.02/L-28.

Në nenin 11 të Ligjit të Procedurës Administrative nr.02/L-28, shprehimisht është parashikuar se *“Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë”*, e që në rastin konkret nënkupton se organi i paditur, brenda kompetencave të veta ka pasur obligim ligjor që të vendos për ankesën e paditësit të ushtruar ndaj aktvendimit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës Hani i Elezit 08-nr.2653/93-2017 të datës 23.05.2017, dhe në kuptim të nenit 84, 85 dhe 86 të LPA, të nxjerr vendim i cili ka formën, përmbajtjen dhe arsytimin e përcaktuar me ligj.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe në këtë drejtim, gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë t’i shqyrtoj edhe njëherë pretendimet e paditësit të paraqitura në ankesën e datës 01.06.2017 të dorëzuar tek e paditura, lidhur me ngarkesën vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit për vitin 2017. E paditura me rastin e nxjerrjes së vendimit të aktit administrativ të ri, duhet që të njëjtin ta nxjerr dhe ta mbështesë në dispozitat ligjore në fuqi respektivisht Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe gjendjen faktike të konstatuar gjatë procedimit administrativ, duke u bazuar në provat materiale të siguruar sipas ligjit. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për të paditurën, bazuar në nenin 65 të LKA-së.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 35 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal
A.nr.1010/17, datë 10.04.2020

Zyrtarja Ligjore
Asliha Fejzullahu

Gjyqtari
Rexhep Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.